

SCC – 08 – 0269

11 shkurt 2010

Paditësi

[REDACTED], nga fshati Llaplje Sellë
Përfaqësuar nga [REDACTED] Avokat nga Prishtina,
[REDACTED]

Kundër

Të Paditura

1. [REDACTED]
2. [REDACTED]

Për: Përfaqësuesin e Paditësit, [REDACTED]

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Trupi Gjykses i përbërë nga Laura Plesa, Gjyqtare Kryesuese, Anna Bednarek dhe Gyltene Sylejmani, Gjyqtare, pas seancës së vendimmarrjes të mbajtur më 11 shkurt 2010 lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. Refuzohet padia e [REDACTED] si e papranueshme.
2. Sopas Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankimi kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 10 tetor 2008, Paditësi ka ushtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit me të cilën ka kërkuar që Dhoma e Posaçme ta anulojë kontratën për shitblerje të pasurisë së patundshme, Cert. No. 1660/61 të datës 14 korrik 1961 dhe Cert. No. 3023/63 të datës 20 nëntor 1963, në mes të Paditësit si shitës dhe Ko-operatives Bujqësore "[REDACTED]" nga Graçanica dhe Kombinatit Agro-industrial "[REDACTED]" nga Prishtina, tani "[REDACTED]" nga Fushë Kosova si blerës dhe që ta obligojë të Paditurën që t'ia kthej në posedim paditësit, parcelat kadastrale nr. 101, 1695/4, 270/1, 308/1, 315/1 dhe 1834/2 të Komunës Kadastrale Llaplje Sellë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.98, 91, ha dhe ta obligojë paditësin që t'ia kthejë të paditurës çmimin blerës, një shumë që do të përcaktohej nga eksperti financiarë, të gjitha

këto Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga hyrja në fuqi të aktgjykimit të Dhomës së Posaçme nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Me 20 nëntor 2008, Dhoma e Posaçme kam kërkuar nga Paditësi që brenda 15 ditëve nga pranimi i urdhrin të dorëzoj:

1. *Kopjet më të fundit nga Regjistri i të Drejtave Pronësore të Pasurisë së Patundshme ("Regjistri") në lidhje me të drejtat pronësore të parcelave të tokës të cekura në padinë e tij. Kopjet e kërkuara të lëshuara nga Drejtoria kompetente Kadastrale e Komunës duhet të dokumentojnë bazën ligjore (Vendimi gjyqësor, Vendimi administrative, Kontrata e shitjes etj) sipas të cilave këto të drejta pronësore janë evidentuar në regjistr.*
2. *Detajet precize të Ligjit, në bazë të se cilit kontrata e kontestuar për shitblerje (sipas së cilit parcelat përkatëse ishin marrë nga posedimi I trashëgimtarëve ligjor të Paditësit) ishte lidhur në mes të palëve, duke cekur se cilat mjete juridike epehshin nga ai ligj.*
3. *Detajet precize se nëse marrja e tokës ishte e kontestueshme në atë kohë dhe nëse po, para cilave organeve dhe në çfarë kohe.*
4. *Detajet precize të provave të cilat paditësi ka për qëllim të paraqes gjatë shqyrtimit të lëndës për të vërtetuar pohimet e tija."*

Paditësit i qe tërhequr vërejtja se mos-respektimi i këtij urdhri mund të rezultojë në hedhje poshtë të padisë si e papranueshme. Paditësi e ka konfirmuar pranimin e urdhrin me 2 dhjetor 2008.

Me 12 dhjetor 2008, Paditësi ka dorëzuar një parashtrësë në të cilën theksonte se nuk ishte në gjendje ta siguronte flet-posedimin e kërkuar, sepse Drejtorati për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Prishtinës ia kishte refuzuar atij dhënien e atyre dokumenteve. Paditësi ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme sigurimin e atij dokumentacioni nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë I Komunës së Prishtinës. Pastaj, Paditësi ka theksuar se nuk ka ligj të veçantë lidhur me kontratat mbi shitblerje të pasurisë së patundshme. Në vend të tij, Paditësi i referohej parimeve të përgjithshme kontraktuese dhe Nenit 8 a të Ligjit mbi Qarkullimin/Transferimin e Pasurisë së Patundshme (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë Nr. 28/87) si dhe Nenit 110 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Kontraktuese. Paditësi ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta dëgjojë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], që të dy nga Llaple Sella. Paditësi i ka propozuar Dhomës së Posaçme që ti caktojë dy ekspertë, njëri për identifikim të parcelave kontestuese dhe tjetri për vlerësim të çmimit real.

Me 23 dhjetor 2009, Dhoma e Posaçme ka lëshuar dy urdhra. Njëri iu dërgua Drejtoratit për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Prishtinës duke kërkuar nga ai që Brenda 7 shtatë ditëve nga pranimi i urdhrin të dërgojë Dhomës së Posaçme kopjet më të fundit të Regjistrin për të Drejtat Pronësore lidhur me parcelat e përmendura më lart. Tjetri i është dërguar përfaqësuesit të Paditësit, [REDAKTUAR] duke kërkuar që Paditësi ta dërgojë brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga pranimi i urdhrin: dëshminë origjinale mbi autorizimin (jo kopjen) duke përfshirë edhe datën se kur është lëshuar autorizimi së bashku me përkthimin në Anglisht dhe dëshminë se njoftimi I është dhënë Agjencisë në kohë të duhur sipas Neneve 29.1 dhe 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 së bashku me përkthimit në Anglisht.

Paditësit i qe tërhequr vërejtja se mos-dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga pranimi i urdhrin Dhoma e Posaçme do ta refuzojë padinë mbi bazën e papranueshmërisë. Avokati i Paditësit e ka pranuar urdhrin me 6 janar 2010.

Me 13 janar 2010 Dhoma e Posaçme ka pranuar një parashtrësë nga Paditësi me kopje të autorizimit të datës 22 shtator 2008 dhe një kopje të njoftimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të protokolluar nga AKP-ja më 27 tetor 2008.

Arsyetimi Ligjor:

Sipas Nenit 28.2 (e) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 padia mund të jetë e pranueshme vetëm atëherë kur Paditësi e ka njoftuar Agjencinë për qëllimin e tij/saj për të ushtruar padi kundër Ndërmarrjes apo Agjencisë Brenda një periudhe të caktuar sipas Neneve 29.1 ose 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

Neni 29.1 I Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 parasheh se “*asnjë procedurë nuk do të zhvillohet në gjykatë pa sigurimin e dëshmisë se Paditësi ia ka dorëzuar Agjencisë njoftimin me shkrim për qëllimin e ushtrimit të padisë*”. Kjo kërkon që Paditësi ta njoftojë Agjencinë para hapjes së procedurës ligjore, meqë ky kusht I referohet qëllimit të Paditësit për të ushtruar padi.

Meqë Paditësi me padinë e tij nuk ka dorëzuar dëshmi të një njoftimi të tillë, Dhoma e Posaçme, në urdhrin e saj të lëshuar me 23 dhjetor 2009, ka kërkuar nga Paditësi që sipas Nenit 28.4 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 ta dorëzojë dëshminë se njoftimi I ishte dhënë Agjencisë në kohë të duhur sipas Neneve 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

Megjithatë, njoftimi i ushtruar në Dhomën e Posaçme më pas ishte protokolluar nga AKP-ja më 27 tetor 2008, goxha një kohë pas inicimit të procedurës në Dhomën e Posaçme me 10 tetor 2008. Andaj, Paditësi nuk iu ka përmbajtur urdhrin të lëshuar me 23 dhjetor 2009, i cili obligon për dëshmi të njoftimit sipas Neneve 29.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12.

Andaj, Padia refuzohet si e papranueshme në kuptim të Nenit 28.4, lidhur me Nenin 28.2 (e) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6.

Meqë Dhoma e Posaçme nuk ka marrë vendim për meritën e padisë, Paditësi mund të dorëzojë padi të korrigjuar apo të kompletuar në pajtim me ligjin.

Në kuptim të Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, ankimi kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i këtij vendimi..

Laura Plesa, Gjyqtare Kryesuese EULEX	nënshkruar
Anna Bednarek, Gjyqtare Raportuese EULEX	nënshkruar
Gyltene Sylejmani, Gjyqtare	nënshkruar
Tobias Lapke, Regjistruer EULEX	nënshkruar